




Republika e Kosovës – The Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit – Municipality of Hani i Elezit



POLITIKAT E PRIVATËSISË

KOMUNA HANI I ELEZIT



Hyrje

Kjo Politikë e Privatësisë është përpiluar në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale të Republikës së Kosovës. Kjo politikë ju informon se Komuna e Hanit të Elezit mbledh dhe përpunon të dhënat tuaja personale vetëm për qëllime të caktuara dhe për të kryer veprimtari në përputhje me autoritetin zyrtar.

Të Dhënat Personale që Mblidhen

Komuna e Hanit të Elezit mund të mbledhë të dhënat e mëposhtme personale:

- Emri dhe mbiemri
- Adresa e banimit
- Numri i telefonit
- Adresa e email-it
- Të dhëna të tjera të nevojshme për qëllime specifike administrative

Qëllimi i Përpunimit të të Dhënave

Të dhënat tuaja personale mblidhen dhe përpunohen për qëllime të caktuara, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Ofrimin e shërbimeve komunale
- Komunikimin me qytetarët
- Menaxhimin dhe zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave
- Përmbytjen e detyrimeve ligjore dhe rregullative
- Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve tona

Mbledhja dhe Përpunimi i të Dhënave

Komuna e Hanit të Elezit mbledh dhe përpunon të dhënat tuaja personale në përputhje me parimet e ligjshmërisë, ndershmërisë dhe transparencës. Të dhënat tuaja personale do të përpunohen vetëm për qëllimet për të cilat janë mbledhur dhe nuk do të përpunohen më tej në mënyrë që nuk përputhet me këto qëllime. Përpunimi bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe në pajtim me legjislacionin e copian për mbrojtjen e të dhënave personale. Në disa raste, ne përpunojmë të dhënat personale vetëm pas pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave. Pëlqimi i dhënë mund të tërhiqet në çdo kohë nga subjekti.

Siguria e të Dhënave

Ne kemi vendosur masa teknike dhe organizative të sigurisë për të mbrojtur të dhënat tuaja personale nga humbja, keqpërdorimi dhe qasja e paautorizuar. Këto masa përfshijnë:

- Kufizimin e qasjes në të dhënat personale vetëm për personat e autorizuar
- Implementimin e teknologjive të sigurisë së informacionit
- Trajnimin e stafit për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale

E Drejta Juaj

Ju keni të drejtë të kërkonti qasje në të dhënat tuaja personale që mbahen nga Komuna e Hanit të Elezit. Ju gjithashtu keni të drejtë të kërkonti korigjimin, fshirjen ose kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja personale, në përputhje me dispozitat ligjore të aplikueshme apo të ankoheni në çdo kohë nëse besoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur. Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të paraqesë ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi me adresë: Rr. Zejnel Salihu - Nr.22, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Kontakt

Nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim lidhur me përpunimin e të dhënave tuaja personale, ju lutemi të kontaktoni Komunën e Hanit të Elezit në:

Adresa: rr.Nuri Bushi, nr.2 Hani i Elezit.

Email: komunahaniielezit@gmail.com Telefon: 080011017

Kjo Politikë e Privatësisë mund të përditësohet herë pas here. Ndryshimet do të publikohen në faqen tonë zyrtare <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/>

Ky dokument është i përgatitur për t'u përfshirë në faqen zyrtare të Komunës së Hanit të Elezit, me qëllim të informimit të qytetarëve mbi mënyrën se si mbrohen dhe përpunohen të dhënat e tyre personale.